



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika "d" e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-124405/20 dt. 22.07.2020, të pronarit Sejdi Gashi nga Prishtina, me investitor "Dardania SH Comapny" Sh.P.K. nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810859126, me përfaqësues Shqiptar Novosella, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+11, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban "b_17" të nën tërësisë "B-4", të tërësisë "B" të Planit rregullues "Muhaxhirët", në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 25.11.2021 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarit Sejdi Gashi nga Prishtina, me investitor "Dardania SH Comapny" Sh.P.K. nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810859126, me përfaqësues Shqiptar Novosella, sipas kërkesës 05 Nr.351/04-124405/20 dt. 22.07.2020, për përdorimin e ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+11, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban "b_17" të nëntërësisë "B-4" të tërësisë "B" të Planit rregullues "Muhaxhirët", gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale 10143-1, Zona Kadastrale Prishtinë, sipas Vendimit 05Nr.351-179126 dt. 25.01.2017 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës dhe Vendimit mbi miratimin e ndryshimeve 05Nr.351-179126/1 dt. 22.01.2018.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-179126 dt. 25.01.2017, dhe Vendimit mbi miratimin e ndryshimeve 05Nr.351-179126/1 dt. 22.01.2018, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

V. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari Sejdi Gashi nga Prishtina, me investitor "Dardania SH Comapny" Sh.P.K. nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810859126, me përfaqësues Shqiptar Novosella,, më kërkesën me 05 Nr. 351/04-124405/20 dt. 22.07.2020, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e

certifikatës së përdorimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+11, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certifikate.

Paraprkishtë Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare “Akt Përcjellës me referencë 09 Nr. 391/2-139918/19 dt. 12.01.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektimit final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e udhëzimit administrativ MMPH Nr. 05/2017 për blikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f
- Vendimin nr. 05 Nr. 351-179126 dt. 25.01.2017 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+11 pronarit Sejdi Gashi nga Prishtina, me investitor “Dardania SH Comapny” Sh.P.K. nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810859126, me përfaqësues Shqiptar Novosella e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “b_17” të nëntërësisë “B-4” të tërësisë “B” të Planit rregullues “Muhaxhirët”, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale 10143-1, Zona Kadastrale Prishtinë.
- Vendimin mbi miratimin e ndryshimeve në projektin kryesor, nr. 05 Nr. 351-179126/1 dt. 22.01.2018 në emër të pronarit Sejdi Gashi nga Prishtina, me investitor “Dardania SH Comapny” Sh.P.K. nga Prishtina.
- Dispozita urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Aktvendimin numër 05 Nr. 351-179126 dt.21.12.2016, mbi caktimin e taksës Administrative për lejen e ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Informim mbi caktimin e adresës për objektin me nr. të referencës 05-015/01-53922/19 dt. 07.03.2019, Rr. “Ali Ahmeti” dhe “Shaip Kamberi”
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtës, Visar Emra, IDA. udhëheqës i vend ndërtimit, Gazmend Vokshi, IDA. mbikëqyrës për arkitekturë, Bujar Emra IND. mbikëqyrës për Strukturë, Labinot Dedushi, IDH. mbikëqyrës për Hidro-Instalime, Ismet Krasniqi, IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike, Agron Pajaziti, IDM. Mbikëqyrës për Instalime makinerike, Labinot Dedushi, IDA. mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri, Edona Sheqerolli, gjeodet.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Protokollin e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të Inspektimit Final të Inspektionit të ndërtimit të ndërtesës dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 351/04-124405/20 dt. 22.07.2020 ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zeytare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05 Nr.

351-179126 dt. 25.01.2017, Vendimin nr. 05 Nr. 351-179126/1 dt. 22.01.2018, mbi miratimin e ndryshimeve në projektin kryesor. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm, mund të përdoret.

Në Raportin e Inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspektionit të Ndërtimit.

Kërkesat e Vendimit Lejes Ndërtimore janë zbatuar,

Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,

Masat për kursim të energjisë janë zbatuar.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+11, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 351/04-124405/20 DT. 25.11.2021**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit

Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtori:

Andrian Olluri



